L I G J
Nr.8194, datë 2.3.1997

PËR GJENDJEN E JASHTËZAKONSHME NË RASTET E CENIMIT TË RËNDE TË RENDIT KUSHTETUES E TË RENDIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Gjendje e jashtëzakonshme në rastet e cenimit të rëndë të rendit kushtetues e të rendit publik (në vijim: gjendje e jashtëzakonshme) konsiderohet ajo situatë kur në Republikën e Shqipërisë ose në një pjesë të saj bëhen përpjekje për përmbysjen me dhunë të rendit kushtetues ose ndërpritet me dhunë veprimtaria e strukturave shtetërore, si dhe kur sulmohen depot e armëve të Forcave të Armatosura, fabrikat e prodhimit të tyre e institucionet e shtetit në qendër e në bazë dhe, kur për shkak të kryerjes së veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike, kërcënohet rëndë dhe cenohet jeta ekonomike dhe liritë e individëve.

Neni 2

Gjendje e jashtëzakonshme shpallet me vendim të Kuvendit Popullor. Kur Kuvendi Popullor nuk është i mbledhur, shpallet me dekret të Presidentit të Republikës.

Neni 3

Gjendja e jashtëzakonshme është e pjesshme ose e përgjithshme. Ajo ka karakter të përkohshëm dhe zgjat deri në rivendosjen e rendit dhe të qetësisë publike.

Në rastet kur gjendja e jashtëzakonshme është vendosur me afat të përcaktuar, zgjatja e këtij afati mund të bëhet vetëm me vendim të veçantë të Kuvendit Popullor.

Neni 4

Kur vendoset gjendja e jashtëzakonshme, kufizohen plotësisht të drejtat dhe liritë kushtetuese, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 41 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 "Për një shtojcë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"".

Kur organet e ruajtjes së rendit nuk janë në gjendje që me mundësitë dhe mjetet e zakonshme të tyre të përballojnë, neutralizojnë e eliminojnë veprimtarinë e paligjshme që cenon rendin kushtetues e rendin publik, atëherë në ndihmë të organeve të ruajtjes së rendit, për realizimin e funksioneve të tyre, angazhohen forcat e ushtrisë.

Neni 5

Organet e ruajtjes së rendit kanë të drejtë të bëjnë ndalimin, brenda afateve ligjore, të të gjithë atyre personave për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se përgatisin veprime në dëm të rendit e të qetësisë publike dhe në kundërshtim me rregullat e vendosura nga organet e ngarkuara me ligj për marrjen e zbatimin e masave për ruajtjen e rendit kushtetues e rendit publik, në rast gjendjeje të jashtëzakonshme.

Neni 6

Në rast gjendjeje të jashtëzakonshme ndalohen të gjitha grumbullimet në vende publike si dhe veprimtaritë me karakter politik, sportiv, kulturor a sindikal.

Për shpërndarjen e grumbullimeve në vende publike dhe kur nuk është e mundur që të realizohet kjo me mjete të tera, organet e rendit kanë të drejtë që të përdorin gazin lotësjellës si dhe armët e zjarrit në atë masë që është e domosdoshme për realizimin e detyrës së tyre konform ligjit.

Neni 7

Në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme merren veëanërisht edhe këto masa:

a) Të gjitha objektet shtetërore ose publike konsiderohen "objekte të rëndësisë së veçantë", sipas përcaktimit të organit të ngarkuar dhe mbrohen me roja ushtarake të armatosura.

b) Ndalohet qarkullimi i lirë i individëve në orë të përcaktuara të ditës; në orët kur lejohet qarkullimi i lirë i tyre, kufizohet lëvizja në grupe më të mëdha se 4 persona. Në çdo rast, përjashtimet nga ky rregull mund të lejohen me autorizim të posaçëm.

c) Në rrugët kryesore të hyrjes dhe daljes në qendrat e banuara dhe në institucionet e administratës shtetërore e publike vendosen postoblloqe dhe pika kontrolli.

Neni 8

Veprimtaria për përballimin e gjendjes së jashtëzakonshme drejtohet nga Këshilli i Mbrojtjes.

Në zbatim të dispozitave të këtij ligji, Këshilli i Mbrojtjes shqyrton dhe miraton të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e rendit publik. Këshilli i Mbrojtjes merr masa për bashkërendimin e veprimtarisë së organeve qendrore e lokale, për garantimin e veprimtarisë ekonomike e të nevojave jetësore të shtetasve.

Neni 9

Për zbatimin e masave të gjendjes së jashtëzakonshme krijohet shtabi i mbrojtjes në bazë rrethi (prefekture). Si kryetar i shtabit caktohet prefekti, kurse anëtarë emërohen kryetari i rrethit, dhe i bashkisë, komandanti i njësisë më të madhe ushtarake, drejtuesit e komisariatit të Policisë dhe të Shërbimit Informativ Kombëtar.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi më datën 2.3.1997.

Shpallur me dekretin nr.1727, datë 2.3.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha